



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 416 Prot.

Tiranë, më 3 /03/2017

VENDIM

Nr. 43, datë 3 / 3 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Av. në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të saj, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankimin nr.1276 Prot., datë 14.11.2016, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”) me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Ankuesi, me shkresën e datës 14.10.2016 ka paraqitur pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion si më poshtë:

1. *Kopje të kontratës së lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe Shoqërisë 3R sh.p.k, datë 15.12.2015 me objekt “Mbi punësimin e individëve që mbledhin materiale të riciklueshme nëpër qytet dhe seleksionimin e këtyre materialeve para se të futen në zonën e asgjësimit të tyre”.*
2. *Nëse ka, masat që janë marrë për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate.*

Autoriteti Publik i është përgjigjur kërkuarit me shkresën nr. 31683/1 Prot, datë 28.10.2016, duke argumentuar: “...Menaxhimi në terren i Landfillit të Sharrës është i organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit. Kjo drejtori, pas konstatimit fizik të llojit të mbetjeve, të cilat shkojnë për t’u depozituar në këtë Landfill, mundëson edhe pranimin e tyre, në përputhje me legjisilacionin në fuqi.

Drejtoria e Trajtimit Mbetjeve, Landfill dhe Riciklim pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit bën trajtimin e mbetjeve urbane që depozitohen në Landfillin e Sharrës nëpërmjet proceseve teknologjike si shtyrje, nivelim, ngjeshje dhe mbulim me dhe të tyre. Përsa i takon problematikës së Riciklimit në Landfillin e Sharrës, sqarojmë se çështja po ndiqet me prioritet nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë”.

Ankuesi pretendon se përmbajtja e shkresës së Autoritetit Publik nuk i përgjigjet kërkesave të tij për informacion dhe se rrjedhimisht ai është cënuar në të drejtën për informim.

Në këto kushte ankuesi kërkon nga Komisioneri, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për të dhënë informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr.1276/1 Prot., datë 15.11.2016, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, Komisioneri, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 21.11.2016.

Me shkresën 35424/1 Prot., datë 23.11.2016 Autoriteti Publik, ka kthyer përgjigje duke mos e vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar sipas objektit të shkresës së sipërcituar. Pas shqyrtimit të ankesës si dhe konsultimit të legjislacionit, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica" është informacion publik dhe si i tillë, duhet vendosur në dispozicion të kërkuarit. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik.

Për më tepër, sa i përket masave të marra për zbatimin dhe monitorimin e kontratës, ato bëjnë pjesë në atë kategori informacioni që sipas pikës iv ë) të nenit 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" duhet të bëhet publik pa kërkesë.

Në këto kushte, në lidhje me ankimin e Qendrës "Res Publica" kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës I të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative'.

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit të Qendrës "Res Publica", Nr. 1276 Prot., datë 14.11.2016, ndaj Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës (Kopje të kontratës së lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe Shoqërisë 3R sh.p.k, datë 15.12.2015 me objekt "Mbi punësimin e individëve që mbledhin materiale të riciklueshme nëpër qytet dhe seleksionimin e këtyre materialeve para se të futen në zonën e asgjësimit të tyre", si edhe nëse ka, masat që janë marrë për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate) brenda datës 10.03.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 3 . 3 .2017.

